



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 23.07.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Diskutim mbi problematikën e krijuar për funksionalitetin e Gjykatës së Lartë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:10 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
8. *Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
9. *Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Marjana Papa, OSCE.*
11. *Migena Kondo, KSHH.*
12. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
13. *Klodian Rado, EURALIUS.*
14. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
15. *Erion Fejzulla, USAID.*
16. *Julinda Karaboja, USAID.*
17. *Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. Diskutim mbi problematikën e krijuar për funksionalitetin e Gjykatës së Lartë.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë sot mbledhjen e datës 23 korrik 2019.

Faleminderit për prezencën e të gjithë anëtarëve dhe të përfaqësuesve që monitorojnë mbledhjet e Këshillit.

Siç jeni në dijëni, për këtë mbledhje, sipas rendit të ditës, kemi për diskutim dy çështje kryesore. Çështja e parë ka të bëjë lidhur me problematikat e krijuara për funksionalitetin e Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh situatën aktuale që ndodhet në Gjykatën e Lartë dhe çështja e dytë, ka të bëjë me projektvendimin për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me datë 19.07.2019. Edhe kjo çështje është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Në eventualitetin që... këto janë dy çështje të cilat neve kemi parashikuar për këtë mbledhje. Përpara se t'ia kaloj fjalën relatorit të çështjes së parë, që është Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku, lidhur me prezencën e mediave, sikurse kemi mbajtur gjithmonë një standard, ne vazhdojmë të jemi të qëndrimit që të gjithë gazetarët mund të jenë të pranishëm në sallën tonë, ndërkohë që për sa i përket prezencës së kamerave, ato mund të largohen, për të vazhduar diskutimin tonë të punës këtu.

(Kameramanët largohen nga salla e mbledhjes.)

Atëherë, zoti Qoku, të lutem, vazhdoni me trajtimin e çështjes së parë lidhur me pasqyrimin e situatës problematike që është krijuar në Gjykatën e Lartë.

Maksim Qoku: Faleminderit, zonja Kryetare!

Sikurse edhe e kemi biseduar pas një vendimmarrje konsensuale nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, më është caktuar që të jem relator për sa i përket bërjes së një relacioni për situatën juridike në emergjencën aktuale në të cilën ndodhet Gjykata e Lartë. Kështu që, në bërjen e këtij opinioni, natyrisht që kam bërë një referim në të gjitha informacionet që janë dërguar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor nga kryetari i Gjykatës së Lartë dhe në vazhdimësi. Jam bazuar në tërësinë e vendimmarrjeve të organeve të pavarura të vettingut, në opinionin ligjor të Misionit EURALIUS, në dokumentacionet që ndodhen pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, konkretisht dokumentacion i cili është përdorur edhe nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës si dhe në dispozitat ligjore përkatëse të legjislacionit në fuqi.

Çështja e parë e këtij relacioni ka të bëjë me analizën mbi situatën faktike në Gjykatën e Lartë.

Që nga momenti i krijimit të Gjykatës së Lartë, organika e kësaj gjykate, në bazë të ligjit të kohës u përcaktua me një përbërje prej 17 anëtarësh, ndërkohë që pas ndryshimeve ligjore të bëra në vitin 2013, në ligjin organik nr.8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” (aktualisht i shfuqizuar), u parashikua që kjo organikë të bëhej me 19 anëtarë.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë dërguar aktualisht, disa informacione shkresore nga Gjykata e Lartë, kjo për faktin se nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i është kërkuar kësaj të fundit të japë një informacion të plotë mbi gjendjen e mandateve të të 19 anëtarëve të saj që janë emëruar në periudhat e fundit.

Sipas informacioneve shkresore që janë sjellë nga Gjykata e Lartë, janë vetëm 17 anëtarë sepse asnjëherë nuk mundën të bëhen 19, prej situatës ligjore të kohës.

Unë kam referuar të gjithë anëtarët, duke u ndalur tek pozicioni në të cilin janë, nëse është i lirë ose jo dhe u ka mbaruar mandati, kështu që në përmbledhje të këtij parashtrimi mund të thuhet që:

3 prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë iu ka mbaruar mandati, përpara se të përfshiheshin në procesin e vetting-ut;

5 prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë iu ka mbaruar mandati, pasi KLGJ-ja ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit, për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të lirë në gjykatë apeli;

6 prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë iu ka mbaruar mandati, për shkak të shkarkimit të tyre nga detyra, me vendim përfundimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;

1 prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë nuk e ushtron detyrën pranë kësaj gjykate, për shkak të zgjedhjes si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një periudhë 3 vjeçare dhe për pasojë mandati i tij 9-vjeçar mbetet i pezulluar;

Aktualisht në detyrë janë 2 (dy) prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë, njërit prej tyre mandati 9-vjeçar i ka përfunduar, por ky i fundit vijon në ushtrimin e detyrës deri në zëvendësimin e tij nga një anëtar tjetër dhe pozicioni i tij aktualisht konsiderohet i lirë, ndërsa anëtari tjetër është në pritje të vendimmarrjes nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit,

por gjithsesi mandati këtij të fundit nuk ka përfunduar akoma dhe pozicioni aktualisht nuk konsiderohet i lirë.

Pra, në mënyrë të përmbledhur, nga 17 anëtarë, që ka faktikisht në Gjykatën e Lartë, 14 prej tyre nuk ushtrojnë detyrën pranë kësaj gjykate, për shkak të mbarimit të mandatit me arsyet e sipërcituara. Një anëtar e ka të pezulluar mandatin, për një periudhë 3-vjeçare, sipas arsyeve që përmendëm sa më sipër. Ndërkohë që vetëm dy anëtarë janë në detyrë, njëri me mandat të papërfunduar, por në pritje të vendimit përfundimtar nga organet e vetting-ut dhe anëtari tjetër me mandat të përfunduar, por në pritje të zëvendësimit të tij nga një anëtar i ri.

Për këtë arsye, si problemi më i rëndësishëm dhe emergjent, që shfaqet si një sfidë për Këshillin e Lartë Gjyqësor aktualisht, është pamundësia për formimin e të paktën një trupe gjyqësore me tre gjyqtarë, për të vijuar normalitetin në Gjykatën e Lartë.

Aktet nënligjore që janë miratuar nga Këshilli deri më tani, kanë hapur rrugën për të marrë masat e nevojshme, për dhënien e një zgjidhjeje sa më të shpejtë nga ana e KLGJ-së, por deri në arritjen e një zgjidhjeje të tillë, do të duhet të kalojë një kohë relativisht e caktuar, e cila ka të bëjë me respektimin e procedurave të përcaktuara nga ligji dhe aktet nënligjore.

Për sa i përket çështjes së dytë të këtij relacioni, në lidhje me angazhimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në problematikën e Gjykatës së Lartë.

Këshillit i Lartë Gjyqësor, është i angazhuar që të ofrojë të gjitha garancitë, për një sistem gjyqësor funksional, të paanshëm dhe me integritet, por mbi të gjitha me fokusin tek qytetarët, parashikuar kjo edhe në nenin 147 të Kushtetutës, në të cilin thuhet që: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ndër të tjera, Këshilli i Lartë Gjyqësor me qëllimin për përmbushjen e të gjitha përgjegjësiave për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor dhe respektimit të parimit qeverisës dhe të efijencës, si dhe ushtrimin e kompetencave të plota, në lidhje me administrimin e sistemit gjyqësor, mbështetet në vendimmarrjen e tij, duke u bazuar përkatësisht edhe në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nisur nga sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbetet i angazhuar në vazhdimësi, për sa i përket problematikës aktuale që ka shfaqur Gjykata e Lartë, duke marrë në konsideratë disa nga çështjet më delikate të kësaj problematike, të cilat kanë të bëjnë në këto drejtime:

Së pari, plotësimin përfundimisht të trupës gjyqësore në Gjykatën e Lartë, me numrin e nevojshëm të gjyqtarëve magjistratë dhe jo magjistratë, duke respektuar raportin që parashikon ligji midis tyre, sipas përcaktimeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi;

Së dyti, trajtimin e “backlog-ut” (pra çështjeve të prapambetura gjyqësore) në përgjithësi me masa efektive, duke pasur parasysh numrin e madh të çështjeve të mbartura në Gjykatën e Lartë, si dhe atyre që regjistrohen vazhdimisht në këtë gjykatë;

Së treti, shmangien përfundimisht të vonesave në trajtimin e çështjeve gjyqësore, vonesa të cilat pasjellin një sistem të mbingarkuar dhe jo efikas, i cili jep efekte në një drejtësi të vonuar për qytetarët;

Së fundi, pavarësisht efekteve negative të procesit të “vetting-ut” në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përgjegjësinë kushtetuese dhe ligjore, që të garantojë funksionalitetin e të gjitha gjykatave në përgjithësi, por edhe të Gjykatës së Lartë në veçanti, pasi mos funksionaliteti i këtyre të fundit do të cenojë parimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve.

Për rrjedhojë, në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 05.07.2019, me vendimin nr. 102, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtare dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”, botuar në Fletoren Zyrtare të datës 08.07.2019, u krijuan premiset për nisjen e procesit të emërimit të kandidatëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë.

Vendimi në fjalë pasoi vendimin ekzistues, të miratuar më parë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, atë me nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, nëpërmjet të cilit është rregulluar procedura që do të ndiqet për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për

rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës dhe emërimin e tyre në Gjykatën e Lartë.

Në vazhdimësi të përmbushjes së kësaj procedure, në kushtet e miratimit të akteve nënligjore të nevojshme, për verifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve jo-gjyqtarë, për propozimin e tyre për emërim në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vijuar më tej, me miratimin e vendimeve nr.108, nr. 109 dhe nr. 110, të datës 09.07.2019 “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur”.

Nëpërmjet këtyre vendimeve respektive, Këshilli i Lartë Gjyqësor mundëson përfundimisht çeljen e procesit të emërimit të kandidatëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, duke mundësuar edhe identifikimin e kandidatëve që përfaqësojnë juristin më të spikatur, në kuptim të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu identifikohen ata kandidatë që mbartin edhe ekspertizën e veçantë në fusha të specifike të së drejtës, në referim të nenit 31 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me organizimin nëpërmjet tre kolegjeve të Gjykatës së Lartë, konkretisht Kolegjit Civil, Kolegjit Penal dhe Kolegjit Administrativ, që në thelb përcakton edhe fushat respektive të së drejtës, në bazë të të cilave do të profilizohen të gjithë anëtarët (gjyqtarëve ose jo-gjyqtarë) e kësaj gjykate.

Në çështjen e tretë të këtij relacioni kam bërë një identifikim të problematikave më emergjente në Gjykatën e Lartë, aktualisht.

Në këtë nënndarje kemi trajtuar një tërësi problematikash emergjente, për sa i përket stokut të çështjeve që presin për t’u gjykuar në Gjykatën e Lartë, duke synuar dhe renditjen e tyre sipas rëndësisë më të madhe dhe natyrës urgjente që shfaqin këto problematika.

Së pari, aktualisht dhe në vazhdim, problematika më emergjente që pritet të krijohet, si pasojë e mosfunksionimit të Gjykatës së Lartë, është shqyrtimi i çështjeve në lidhje me kërkesat për ekstradim, të cilat në rastet e rekurseve nëse nuk përfundojnë

brenda afatit 3-mujor nga regjistrimi i tyre, passjellin në kuptim të nenit 493 të KPP revokimin në masë shtrënguese, përfshirë këtu edhe arrestin në burg.

Sipas nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, në rastet e ekstradimit apo transferimit të të dënuarve, vendimi gjyqësor, në rastin kur ankimohet merr formë të prerë në Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se, mos përfundimi në Gjykatën e Lartë i procedurave gjyqësore të ekstradimit brenda afatit 3-mujor është shkak për revokim të masës së sigurimit.

Së dyti, problematikë emergjente është edhe pamundësia e shqyrtimit të parashtrimeve apo ankimeve të veçanta civile, ndaj vendimeve të ndërmjetme apo jo përfundimtare të gjykatave mbi kompetencën apo juridiksionin, sipas neneve 61, 64 apo 59 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat pasjellin pezullimin e gjykimit, për sa kohë Gjykata e Lartë nuk gjykon dot.

Së treti, një tjetër çështje emergjent është edhe pamundësia e shqyrtimit të parashtrimeve apo ankimeve të veçanta administrative, ndaj vendimeve të ndërmjetme apo jo përfundimtare të gjykatave mbi kompetencën apo juridiksionin, sipas neneve 61, 64 apo 59 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat passjellin pezullimin e gjykimit dhe çështja qëndron e pezulluar, për sa kohë Gjykata e Lartë mundet të gjykojë.

Së katërti, pamundësia e shqyrtimit të parashtrimeve të paraqitura nga ana e gjykatave penale, për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave apo transferimit të çështjeve, shihet si një tjetër çështje e cila kërkon zgjidhje. Duke qenë se këto vendime janë shkak për pezullimin e procesit në gjykatën referuese, pamundësia e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Lartë, mund të shkaktojë pasoja në kohëzgjatjen e masave të sigurimit personal dhe ato pasurore, si dhe në vetë procedimet penale.

Së pesti, problematikë emergjente është edhe pamundësia e Gjykatës së Lartë të shqyrtojë kërkesat urgjente administrative, për pezullimin e vendimeve gjyqësore administrative të formës së prerë objekt rekursi, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile. Për të gjitha kërkesat e pashqyrtuara për shkak të pamundësisë objektive, ky mjet ligjor ankimi është i destinuar të mbetet joefektiv, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ, sidomos kur kërkues është individ. Gjithsesi, në rastin kur kërkues është shteti, pasojat e

pamundësisë së shqyrtimit do të godasin buxhetin e shtetit dhe veprimtarinë normale të institucioneve.

Së gjashti, pamundësia e Gjykatës së Lartë të shqyrtojë kërkesat urgjente civile, për pezullimin e vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë objekt rekursi, sipas nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile, ku për të gjitha kërkesat e pashqyrtuara për shkak të pamundësisë objektive, ky mjet ankimi është i destinuar të mbetet joefektiv, në kuptim të nenit 13 të po kësaj Konvente.

Së shtati, problem emergjent është edhe pamundësia e Gjykatës së Lartë, për të shqyrtuar rekursat e drejtpërdrejta për papajtueshmëri të trupit gjykues në proceset penale, sipas nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo pamundësi passjell pezullimin e gjykimit në gjykatën e shkallës së parë apo apel dhe se kohëzgjatja e paparashikuar e pezullimit, mundet të shkaktojë efekte të pakthyeshme juridike mbi masat e sigurimit dhe të vetë procedimin penal.

Së teti, problematikë emergjente është edhe “eksodi” i të gjithë çështjeve që presin të gjykohen në Gjykatën e Lartë, në drejtim të GJEDNJ. Shembulli se si GJEDNJ e kualifikoi Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë, si një mjet joefektiv ankimi, tashmë është dhënë në fillimin e vitit 2018 dhe në kushtet kur organika efektive e saj ishte me 15 gjyqtarë, apo thënë ndryshe në kohën kur nuk gjykonte subjektivisht. Tashmë pas kësaj jurisprudence, është krejtësisht e pritshme se çfarë do të ndodhë me çështjet që mundet të ikin nga juridiksioni i pa ezauruar i Gjykatës së Lartë, e cila nuk gjykon tashmë objektivisht.

Së nënti, tjetër çështje është edhe rritja e pakthyeshme e ngarkesës së Gjykatës së Lartë, si dhe zgjatja në mënyrë të pakthyeshme dhe të paarsyeshme e të gjithë proceseve, ku si shkak kryesor do të jetë pamundësia e funksionimit të Gjykatës së Lartë.

Së dhjeti, problem emergjent është edhe mospasja e mundësisë, që në situatën e pas-ndryshimeve të mëdha të ligjeve procedurale, për të unifikuar dhe njësuar praktikën gjyqësore. Kjo do të shkaktojë pasojë vështirësish të rikuperueshme, në drejtim të parimit kushtetues të sigurisë juridike dhe barazisë para ligjit.

Së njëmbëdhjeti, çështje e rëndësishme, megjithëse me natyrë perspektive, është edhe sjellja subjektive e palëve dhe avokatëve të tyre, të cilët duke ditur se kërkesat e

sipërpërmendura, pamundësojnë vazhdimësinë e procedimit të rregullt ligjor të çështjeve, mund të abuzojnë duke i përdorur si mjete përfitimi në formën e strategjive të mbrojtjes në realizimin në vazhdimësi të kërkesave të tilla, me qëllim pamundësimin e vijimit natyral të procesit gjyqësor. Efektet e kësaj perspektive do të jenë fatale, për të gjitha gjykimet në mbarë Shqipërinë, pavarësisht llojit apo shkallëve të gjykatave. Padyshim që kjo do të shkaktonte pezullimin e çdo çështje dhe potencialisht edhe mbingarkesën e Gjykatës së Lartë

Së dymbëdhjeti, problematikë e konsiderueshme do të jetë edhe fakti që ka të bëjë me pamundësinë e shqyrtimit të rekurseve penale, mbi masat e sigurimit të vendosura në apel. Natyrisht nuk ndodhemi përpara një emergjence sikurse më lart, pasi masa e sigurimit nuk humbet fuqinë nga mos shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, por gjithsesi bën të pamundur shqyrtimin e pretendimeve lidhur me cenimin në kundërshtim me ligjin, të lirisë dhe sigurisë personale.

Së fundi, pamundësia e Gjykatës së Lartë, për të shqyrtuar kërkesat për pezullim të vendimeve penale të formës së prerë objekt rekursi, gjithmonë kur ka raste rreziku të pakthyeshëm dhe emergjentë... Megjithëse pas ndryshimit të nenit 417 të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtarët në Gjykatën e Lartë kanë mbajtur qëndrimin, se nuk ka më kompetencë Gjykata e Lartë të pezullojë vendimet gjyqësore të formës së prerë objekt rekursi. Përsëri kemi të bëjmë me kërkesa të depozituara dhe që janë në pritje të një shqyrtimi gjyqësor nga Gjykata e Lartë.

Për sa referuam, mund të parashtrihen edhe më tej problematika, që rrjedhin nga suprimimi faktik i nenit 135 të Kushtetutës së Shqipërisë, në lidhje me autoritetin më të lartë gjyqësor, pasi në Shqipëri aktualisht pushteti gjyqësor ushtrohet vetëm nga gjykatat e shkallës së parë dhe nga gjykatat e apelit.

Në çështjen e katërt, kam bërë një parashtrim të, -Cilat do të jenë zgjidhjet e mundshme që mund dhe duhen marrë në konsideratë nga organi ynë.

Sa më sipër, referuar edhe në opinionet e EURALIUS, mund të konkludohet që zgjidhja e vetme është ndërhyrja e menjëhershme, në mënyrë që të parandalohet agravimi i mëtejshëm i situatës, në lidhje me pasojat negative që mund të vijnë. Kjo kërkon që i gjithë përshpejtimi dhe përqendrimi i punës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, duhet t'i japë

prioritet absolut plotësimit të vakancave të këtij institucioni. Kjo përtej faktit të plotësimit të tre vendeve vakante, që tashmë janë shpallur nga radhët e jo-gjyqtarëve, duhet gjetur edhe një zgjidhje emergjente, për t'i paraprirë situatës së rëndë në të cilën ndodhet Gjykata e Lartë, duke pasur parasysh që në organikën aktuale prej 19 gjyqtarësh, vetëm dy anëtarë vazhdojnë të jenë në detyrë.

Sa më poshtë po parashtrojmë disa argumente, ne lidhje me atë se cilat mund të jenë disa nga zgjidhjet e mundshme që mund dhe duhet të merren në konsideratë Këshilli i Lartë Gjyqësor;

Së pari, ngritja në detyrë e gjyqtarëve dhe emërimi i kandidatëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 136), Këshilli i Lartë Gjyqësor është organi i cili duhet t'i propozojë Presidentit, kandidatët që zgjidhen nga radhët e juristëve për t'u emëruar në Gjykatën e Lartë, si dhe gjyqtarët që promovohen për në këtë Gjykatë.

Aktualisht Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar tashmë, Rregulloren mbi “Verifikimin e Pasurisë dhe Integritetin e kandidatëve gjyqtarë...” dhe gjithashtu ka miratuar edhe vendimin “Për kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes” për t'u emëruar në vendet e shpallura në Gjykatën e Lartë, përfshirë dhe shtojcën me skemën e pikëzimit. Ndër të tjera janë miratuar edhe vendimet “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur”, që ndër të tjera kanë të bëjnë me përzgjedhjen e kandidatëve, sipas fushave të tyre të ekspertizës. Kjo është e baza ligjore e nevojshme për emërimin e kandidatëve jo-gjyqtarë në Gjykatën e Lartë. Duhet pasur parasysh fakti që, procedura normale parashikon thirrjen e hapur për aplikim të kandidatëve, verifikimin i cili përfshin një kontroll tërësor të pasurisë dhe integritetit, vlerësimin e konkurrentëve dhe renditjen e tyre. Për pasojë gjykohet që kjo procedurë ligjore do të zgjasë afërsisht dy deri në tre muaj. Përveç këtij fakti, vetëm një e pesta e anëtarëve të Gjykatës së Lartë,

d.m.th. faktikisht tre gjyqtarë mund të emërohen nga radhët e jo-magjistratëve, të cilët konsiderohen si juristë të shquar në fushat e veçanta të ekspertizës. Ndërkohë të gjitha pozicionet e tjera nga numri i përgjithshëm i anëtarëve, do të duhet të plotësohet me magjistratë gjyqtarë, të cilët konsiderohen se ngrihen në detyrë.

Nisur nga fakti që Këshilli i Lartë Gjyqësor për shkak të angazhimeve të tjera emergjente dhe ngarkesa që ka pasur, nuk ka arritur që të përfundojë procesin e hartimit të akteve nënligjore, në lidhje me promovimin apo ngritjen në detyrë, të magjistratëve gjyqtarëve për në Gjykatën e Lartë, duhet pasur parasysh, që edhe procedura e promovimit të magjistratëve gjyqtarë për në Gjykatën e Lartë, gjykohet që do të marrë afërsisht të njëjtin afat kohor, pasi më parë të jenë miratuar aktet nënligjore për këtë procedurë. Gjykohet që miratimi i akteve nënligjore, procedura e përzgjedhjes, ajo e ngritjes në detyrë, si dhe procesi i emërimit të zgjasë edhe të paktën tre muaj të tjerë.

Për këto arsye, është mjaft e nevojshme që sa më shpejt të jetë e mundur, të përshpejtohet puna për hartimin dhe miratimin pa vonesë të këtyre akteve, si dhe të bëhen thirrjet përkatëse për aplikim, menjëherë sapo këto akte natyrisht të jenë miratuar.

Megjithatë nisur nga fakti që kjo procedurë, aktualisht për situatën në fjalë nuk është efikase, duhet që për të siguruar të paktën një minimum funksionaliteti të Gjykatës së Lartë, është e nevojshme të ndërmerren masa të tjera të përkohshme.

Skema e Delegimit (një zgjidhje e dytë) - Sipas nenit 45 paragrafi i 1 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku thuhet: “Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t’u komanduar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill”. Neni 45 në paragrafin 4 të po këtij ligji thotë: “Këshilli cakton magjistratin në skemën e delegimit, në bazë të nevojave të një gjykate ose prokurorie në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magjistrati përmbush kërkesat.”

Vihet re që edhe ligji “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” edhe rregullorja “Mbi kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarëve” të miratuar nga KLGJ-ja, nuk përjashtojnë mundësinë e caktimit të një gjyqtari në skemën e delegimit për të gjykuar në Gjykatën e Lartë. Në çdo rast, e rëndësishme është që gjyqtari duhet të përmbushë kriteret që përcakton ligji, për t’u

emëruar në Gjykatën e Lartë të përmendura në nenin 136, paragrafi 3 të Kushtetutës, i cili referon me termin "...të paktën 13 vite eksperiencë profesionale". Megjithatë, duhet pasur parasysh, që caktimi i një gjyqtari në skemën e delegimit në Gjykatën e Lartë, duhet të dallohet thelbësisht nga emërimi i përhershëm i tij në këtë gjykatë. Një gjyqtar i përzgjedhur në skemën e delegimit, mbetet i përfshirë në skemën e delegimit dhe do t'i nënshtrohet vetëm dispozitave ligjore rregulluese të kësaj skeme, pavarësisht nga gjykata në të cilën do të ushtrojë funksionin.

Megjithatë është vënë re, që edhe pse KLGJ-ja ka shpallur disa thirrje publike për pjesëmarrjen në këtë skemë, deri tani vetëm pak gjyqtarë kanë aplikuar për t'u komanduar në këtë skemë. Sidoqoftë, është bërë dhe refuzimi i disa gjyqtarëve të interesuar për në skemën e delegimit, pasi komandimi i këtyre kandidatëve do të kishte krijuar probleme funksionaliteti, në gjykatat nga ku ata janë duke ushtruar detyrën. Ndërkohë që procesi i ngritjes në detyrë në mënyrë të përhershme, në Gjykatën e Lartë është ende pa filluar, presumohet që për këtë periudhë tranzitore, shumë gjyqtarë do të ishin të interesuar për të shërbyer në skemën e delegimit, me qëllim për t'u caktuar përkohësisht në Gjykatën e Lartë.

Si rregull, thirrja për aplikim për në skemën e delegimit, duhet të përfshijë disa specifikime:

Së par, me qëllim që të mund të caktohen nga skema e delegimit në Gjykatën e Lartë, gjyqtarët duhet të përmbushin kriteret formale ligjore që përcaktohen për në Gjykatën e Lartë. Këto kritere të veçanta duhet të jene taksative dhe të qarta në njoftim, afati kohor të jetë i kufizuar, si dhe të garantohet e drejta e magjistratit për t'u kthyer në pozicionin e tij, në gjykatën ku ka pasur emërimin, pas shërbimit në skemën e delegimit.

Së dyti, me qëllim që të shmanget aspekti i nepotizmit, Këshilli mund që të marrë në konsideratë edhe plotësimin e disa kërkesave objektive, të cilat mund të jenë një vlerë e shtuar për kandidatët, që do të caktohen të gjykojnë në Gjykatën e Lartë nga skema e delegimit; si p.sh. të kenë kaluar procesin e vettingut; si dhe të përcaktojnë që kandidatët për në skemën e delegimit për në Gjykatën e Lartë, duhet të vijnë nga juridiksioni i gjykatave të apelit.

Së treti, mbetet e rëndësishme që të theksohet, që ligji “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë”, merr në konsideratë eksperiencën e mbledhur në Gjykatën e Lartë, si vlerë të shtuar në vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, si dhe për ngritjen në detyrë të tyre.

Një zgjidhje tjetër, për sa i përket referimit tek transferimi i përkohshëm.

Faktikisht një zgjidhje tjetër që po debatohet shumë ndërmjet palëve, është edhe ajo që ka të bëjë me propozimin për t’u referuar nenit 46 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” që lidhet me situatën për transferimin e përkohshëm.

Në këtë zgjidhje, unë kam parashtruar dy argumente dhe po i ndaj.

Argumenti i parë - Referuar nenit 46 paragrafi 1 të ligjit nr.96/2016 thuhet: “1. Në rastin kur në skemën e delegimit nuk ka magjistratë të disponueshëm, Këshilli mund t’i kërkojë magjistratit në një nga gjykatat ose prokuroritë me ngarkesën më të ulët, i cili përmbush kriteret për t’u transferuar ose për t’u ngritur në detyrë në pozicionin përkatës, të japë pëlqimin që për një periudhë të caktuar të transferohet përkohësisht në atë pozicion. Në këtë rast, Këshilli merr paraprakisht mendimin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë ku ka ushtruar funksionin magjistrati.”

Neni 46 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve...” është, ashtu sikurse edhe neni 45 mbi skemën e delegimit, një dispozitë që parashikohet në Kreun “Transferimi”. Neni 42 i këtij ligji përcakton “Parimet e Transferimit” dhe ndër të tjera parashikon se: “Transferimi” është: a) lëvizja në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga një pozicion në një gjykatë ose prokurori në një pozicion në një gjykatë ose prokurori tjetër të të njëjtit nivel”.

Transferimi si procedurë duhet të dallohet nga ngritja në detyrë apo promovimi, e cila është një lëvizje nga një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë. Lëvizja nga një gjykatë e shkallës së parë ose një gjykatë apeli në Gjykatën e Lartë, natyrisht që nuk është lëvizje brenda gjykatave të të njëjtit nivel (domethënë për t’u konsideruar transferim), por është një lëvizje nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë të një niveli më të lartë dhe prandaj mund të konsiderohet promovim apo ngritje në detyrë.

Megjithatë duhet pranuar, që dispozitat ligjore për skemën e delegimit sikurse edhe ato për transferimin e përkohshëm, duket se janë të një natyre ambigue/të paqarta. Të dy llojet e dispozitave ligjore, kanë si qëllim që t'i mundësojnë KLGJ-së pasjen e mjeteve të duhura, për të garantuar që gjykatat në Shqipëri të kenë gjithmonë një numër të mjaftueshëm gjyqtarësh, në mënyrë që të jenë në gjendje për të garantuar të paktën minimumin e aksesit të qytetarëve në shërbimin e dhënies së drejtësisë, si një prej parimeve themelore në një shtet të së drejtës.

Për këtë arsye, skema e delegimit synon vënien në dispozicion të sistemit gjyqësor, të një numri gjyqtarësh që mund të shërbejnë në çdo shkallë, për sa kohë gjyqtari respektiv, përpara se të transferohet ose promovohet në pozicionin përkatës, i përmbush të gjitha kërkesat ligjore (si p.sh. atë që referuam më sipër, minimumin e kërkuar të eksperiencës profesionale). Ndërkohë e rëndësishme është që të theksohet se, gjyqtarët e skemës së delegimit, mund që të shërbejnë në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor.

Neni 46 paragrafi i parë i ligjit nr. 96/2016 “ Për statusin e gjyqtarëve...”, për sa i përket transferimin e përkohshëm me pëlqim, konsiderohet si një dispozitë ndihmëse dhe që i krijon një mundësi KLGJ-së, për të marrë masat e nevojshme në situata të jashtëzakonshme të emergjencave në gjykata, veçanërisht në rastet kur asnjë gjyqtar nuk është i disponueshëm sipas skemës së delegimit. Neni 46 paragrafi i parë i këtij ligji përdor termin “transferim i përkohshëm” në një pozicion të caktuar, megjithëse përcakton si domosdoshmëri që magjistrati të përmbushë kushtin për t'u transferuar ose ngritur në detyrë për në pozicionin përkatës.

Pikërisht parakushti i përmbushjes së kriterëve për ngritje në detyrë, nuk do të ishte i nevojshëm nëse termi “transferim i përkohshëm” do të kishte kuptimin e kufizuar për lëvizjet vetëm në të njëjtin nivel.

Nëpërmjet një interpretimi kontekstual, mund të pranojmë një të kuptuar të termit “transferim të përkohshëm” si një caktim të përkohshëm, që është i hapur si për lëvizjen e përkohshëm brenda të njëjtit nivel, ashtu edhe për promovimin në një nivel më të lartë. Ndër të tjera duhet theksuar se termi “i përkohshëm”, e bën fare të qartë dallimin midis caktimit të magjistratit përkohësisht në një pozicion, për të bërë të mundur

funksionalitetin e gjykatës, nga caktimi i këtij të fundit në një pozicion të përhershëm, i konsideruar ky veprim si një ngritje në detyrë.

Sipas këtij këndvështrimi, duket se ekzistojnë argumentet në favor të një interpretimi të nenit 46 paragrafi të parë të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve...”, i cili mundëson një transferim të përkohshëm në Gjykatën e Lartë, të atyre gjyqtarëve që japin pëlqimin. Megjithatë, duke pasur parasysh edhe mandatin e kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë të përcaktuar në Kushtetutë, një procedurë e tillë e jashtëzakonshme, do të duhej të përcaktohej vetëm për një afat shumë të kufizuar dhe vetëm nëse është e nevojshme, kur kërkohet në çdo rast që të ruhet funksionaliteti i Gjykatës.

Në rast se KLGJ-ja do të vendosë që të përdorë këtë mekanizëm, i cili rrjedh nga neni 46 paragrafi i parë i ligjit nr. 96/2016, atëherë do të duhet që kriteret e kësaj vendimmarrjeje të përcaktohen në mënyrë shumë të qartë, me qëllim që të respektohen të gjitha parametrat kushtetues, si dhe për të shmangur çdo aspekt që mund të duket si ngritje në detyrë e gjyqtarit përkatës, apo që të krijojë bindjen që i është dhënë statusi i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

Argumenti i dytë brenda kësaj çështjeje është i tillë:

Si një zgjidhje tranzitore dhe urgjente, është transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve që mund të plotësojnë kushtet për emërim në Gjykatën e Lartë, nga organika efektive në tërësi e pushtetit gjyqësor sot, sipas të gjithë përcaktimeve që ka parashikuar ligji nr.96/2016. Kjo do të arrihet duke zbatuar procedurën ligjore të “transferimit të përkohshëm”, sipas ligjit nr.96 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, duke realizuar një interpretim pajtues me Kushtetutën, në lidhje me transferimin e përkohshëm apo funksionimin e skemës së delegimit në Gjykatën e Lartë.

Zgjidhja pajtuese do të ishte e tillë, që edhe transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve edhe skema e delegimit në Gjykatën e Lartë, të funksiononte sikurse edhe rasti i emërimit që parashikon Kushtetuta në mënyrë të drejtpërdrejtë, për prurjet e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë.

Ashtu sikurse përcaktohet në nenin 136 të Kushtetutës, që të kemi një procedurë me dy faza, sikurse bëhet me emërimin e magistratëve në Gjykatën e Lartë:

1) Zgjedhja nga Këshilli i Lartë Gjyqësor;

2) Dekretimi i Presidentit të Republikës;

Kjo do të thotë se mund dhe duhet të konkludohet, që edhe transferimi i përkohshëm i gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, duhet të bëhet nën të njëjtën simetri kushtetuese, sikurse bëhet edhe procesi i emërimit përfundimtar të magistratëve gjyqtarë. Kjo mënyrë procedimi do të shmangte në çdo rast, kontrastin me Kushtetutën, si dhe çdo deficiencë të përditësimit të parimit kushtetues të “check and balance”, duke mos tentuar që të shmangë në asnjë rast institucionin e Presidentit.

Gjithsesi, ky argument i dytë, siç edhe e kemi biseduar, ka probleme mbi aspektin e disponimit me dekret, se do të ishte shumë debat kushtetues nëse do të ndanim nëse dekreti ruan të njëjtën natyrë apo duhet të dallojë midis dekretit për emërim dhe dekretit në rastin e.. kështu që mbetet në dorë të Këshillit edhe ky debat.

Dhe çështja e fundit e ofruar si një zgjidhje, mbetet caktimi i një gjyqtari për gjykimin e një çështjeje të caktuar gjyqësore në Gjykatën e Lartë.

Këshilli mund të përdorë si një zgjidhje të fundit edhe mundësinë, për caktimin e gjyqtarëve për të gjykuar një çështje konkrete, bazuar kjo në kompetencat që i burojnë Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Kushtetuta dhe ligjet specifike përkatës (detyrimi i KLGJ-së për të qeverisur gjyqësorin, për garantuar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe një sistemin gjyqësor funksional). Duhet të theksohet që përdorimi i këtij instrumenti ligjor, çmohet si masa e fundit që mund të ndërmerret, si dhe mund të përdoret vetëm në një rast të veçantë, siç është edhe situata në të cilën gjendet aktualisht Gjykata e Lartë.

Mundësia për të përzgjedhur një gjyqtar të caktuar, për gjykimin e çështjeve të caktuara gjyqësore në Gjykatën e Lartë, mund të përdoret si një instrument zhblllokues për situatën konkrete dhe duhet të jetë pa më të voglin dyshim, instrumenti i fundit ligjor që mund të aplikohet, në mënyrë që të justifikohet të përdoret, vetëm në raste të veçanta dhe emergjente.

Për këtë instrument vlen të theksohet se Këshilli do të duhet të vërë në diskutim parimin e shtetit të së drejtës në këndvështrimin e ligjshmërisë të aktit normativ nga njëra anë, në raport me funksionalitetin e Gjykatës së Lartë në këtë rast, apo të gjykatave në përgjithësi.

Për këtë moment duhet të përmendet se Këshilli, duke u udhëhequr drejt funksionalitetit të gjykatave, parim në të cilin çdo institucion publik është e pa shmangur të mos mbajë në konsideratë gjatë veprimtarisë së tij, miratoi vendimin nr. 30, datë 14.02.2019 “Rregulla për procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Miratimi i këtij vendimi nga Këshilli është bërë pikërisht në kushtet kur nevojat e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit nuk mund të trajtoheshin dhe zgjidheshin përmes dy instrumenteve ligjore, atë të skemës së delegimit, parashikuar nga neni 45 i ligjit për Statusin dhe atij të transferimit të përkohshëm, parashikuar në nenin 46 i ligjit për Statusin, kjo si rezultat i padisponueshmërisë së gjyqtarëve në skemën e delegimit apo pamjaftueshmërisë së burimeve njerëzore në gjykata në atë masë aplikimi i transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve nga një zgjidhje imediate e nevojave funksionale të gjykatave do të shndërrohej gjerësisht dhe në një kohë të shpejt një instrument bllokues i tyre.

Duke mos parashikuar këto dy situata ligjvënësi, praktikisht nuk parashikoi në ligjin e Statusit një mjet ligjor për shmangien e bllokimit të gjykatave në ushtrimin e funksionit të tyre për çështjet gjyqësore të veçanta. Për miratimin e këtij vendimi, Këshilli kërkoi edhe mori paraprakisht edhe opinionin ligjor nga dy misionet e asistencës që mbështesin veprimtarinë e tij, konkretisht nga EURALIUS dhe Projekti “Drejtësi për të gjithë”. Në opinionin e tyre ligjor këto misione kanë theksuar se në mungesë të një parashikimi ligjor që adreson në mënyrën e duhur delegimin pa pëlqim për çështje të caktuara, EURALIUS dhe Projekti “Drejtësi për të gjithë”, në opinione të veçanta nuk shohin asnjë pengesë që Këshilli t’i referohet autoritetit që buron nga Kushtetuta në bazë të nenit 147, paragrafi i parë, ku thuhet “...të sigurojë pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor”, pra gjykatave, “dhe të miratojë një akt normativ të përkohshëm që detajon si trajtohet nevoja për delegimin në një çështje të caktuar pa pëlqim në rastin kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave të gjykatave, plotësimin e shumë vendeve

vakante në këto gjykata. Të dyja mekanizmat janë të nevojshëm për mirë zbatimin e parashikimeve të kapitullit 4.

EURALIUS nënvijëzon se duke i shqyrtuar në harmoni parashikimet e neneve 4, të paragrafit 3, 147, paragrafi i parë dhe 147/a, paragrafi i parë, shkronja /a/ si dhe bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 41/2017, që trajton ndër të tjera edhe kompetencat e Këshillit, ky i fundit ka autoritet të plotë dhe baza ligjore të mjaftueshme për të miratuar dhe vënë në zbatim delegimin për çështje të veçanta pa pëlqim, si një mekanizëm i përkohshëm për t'u përdorur në raste emergjente.

Në këtë kontekst 'me tranzitore' nënkuptojmë 'derisa nevojat aktuale të gjykatave të trajtohen nga skema e delegimit dhe mungesa e burimeve njerëzore të mjaftueshme, të eliminohet plotësisht. Kjo mund të arrihet duke miratuar rregulla të thjeshta tranzitore për delegimin e çështjeve pa pëlqim.

Në vendimin nr. 41/2017, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese thekson: Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj ka theksuar se respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Parimi i shtetit të së drejtës nënkupton veprimin e të gjitha institucioneve shtetërore, sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacisë së Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative.

Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie, dhe në secilin prej këtyre niveleve, qëndron një normë ose grup normash duke përfshirë edhe fuqinë e caktuar juridike. Piramida e akteve normative e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës përcakton marrëdhëniet midis normave juridike të cilat bazohen në raportin e mbi apo nën vendosjes së tyre. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si një burim për aktet e tjera juridike (shih vendimet 55, të datës 27.07.2016, nr. 16, 10.04.2015, nr. 5, 05.02.2015).

Në preambulën e Kushtetutës dhe në nenin 4 të saj deklarohet parimi i shtetit të së drejtës i cili është një nga parimet themelore më të rëndësishme në shtetin dhe në shoqërinë demokratike. Ky parim nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e

arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike (shih vendimin nr. 16, 10.04.2015 të po kësaj gjykate).

Në nenin 4, paragrafi i tretë i Kushtetutës parashikohet se dispozitat kushtetuese zbatohet drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe. Sipas këtij parimi themelor, kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të mënjanohet dhe as të tejkalohet por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti. Përjashtimi kushtetues i parashikuar në këtë dispozitë nënkupton se normat kushtetuese mund edhe të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave.

Pra Kushtetuta përmban dispozita që rregullojnë zbatimin e saj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese, pasi ajo nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës politiko-shoqërore të një vendi, por vetëm parime dhe kriteret bazë mbi të cilat mbështetet apo duhet të mbështetet ajo.

Edhe pse disa çështje që lidhen me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t'u parashikuar nga ligjet dhe akte të tjera normative sipas rastit (shih vendimet nr. 22, 24.04.2015, nr. 2, datë 18.01.2017 i GJK).

Përmes këtij vendimi, Këshilli, në ushtrim të përgjegjësisë së tij kushtetuese, për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, përcaktuar në pikën 1 të nenit 147 të Kushtetutës, si dhe në përputhje me funksionet e tij sipas pikës 1, shkronja /a/ të nenit 147/a të Kushtetutës, duke zbatuar drejtpërdrejtë Kushtetutën, sipas pikës 3 të nenit 4, ka zhbllokuar ngërçin e krijuar në lidhje me funksionalitetin e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në rastin e padisponueshmërisë ligjore të gjyqtarëve në gjykata të caktuara. Por një gjë e tillë nuk mund të thuhet për Gjykatën e Lartë. Në këtë vendim nuk është përfshirë Gjykata e Lartë, ndërkohë që aktualisht ajo është tërësisht jashtë funksionit për sa kohë nuk është

funkcionale qoftë edhe një trup gjykues, e cila të trajtonte më së paku çështjet me karakter urgjent, sensitiv në pikëpamjet me marrëdhëniet ndërshtetërore.

Duke qenë të vetëdijshëm për situatën ligjore, ashtu sikundër edhe për situatën aktuale të Gjykatës së Lartë, ndërsa është duke ndjekur procedurat për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë e për t'i paraprirë çdo situatë që mund të çonte në cenim në marrëdhëniet ndërshtetërore të Republikës së Shqipërisë, referuar obligimeve që burojnë për të nga Konventa Ndërkombëtare e Marrëveshjeve Bilaterale me shtetet respektive.

Këshilli do të duhet të konsiderojë caktimin e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë për gjykimin e çështjeve gjyqësore më së paku për ato që kanë të bëjnë me ekstradimin dhe transferimin për jashtë shtetit të personave të dënuar, çështje për të cilat neni 462 i Kodit të Procedurës Penale parashikon që një vendim i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm është vendimi i Gjykatës së Lartë. Është e kuptueshme që edhe në këtë rast Këshilli të konsiderojë caktimin për gjykimin e këtyre çështjeve ata gjyqtarë që plotësojnë kushtin kushtetues të përvojës minimale në profesion për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, përveçse edhe qenien e tyre të konfirmuar në detyrë, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, çka edhe kjo tashmë përbën një standard kushtetues.

Si konkluzion, ngritja në detyrë e gjyqtarëve për në Gjykatën e Lartë dhe emërimi i kandidatëve jo-gjyqtarë në këtë Gjykatë, përbëjnë prioritetin themelor të veprimtarisë aktuale të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

KLGG-ja duhet dhe do të përshpejtojë sa më shumë që të jetë e mundur përmbylljen e procedurave të nisura të emërimit të jo-gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, si dhe procesin e hartimit të akteve nënligjore të nevojshëm për realizimin e procedurave të promovimit të gjyqtarëve në këtë gjykatë.

Me qëllim që të kalohet kjo periudhë tranzitore, ndërkohë që procesi i ngritjes në detyrë dhe i emërimit në Gjykatën e Lartë nuk ka përfunduar ende, KLGJ-ja duhet të marrë në konsideratë dhe të përdorë një nga opsionet e parashtruara sa më sipër, pra a) aplikimin e skemës së delegimit të gjyqtarëve sipas nenit 45 të ligjit për Statusin, duke rishpallur thirrjen për aplikim në skemën e delegimit dhe ftuar për t'u bërë pjesë e saj ata gjyqtarë që përmbushin kriteret formale ligjore që kërkohen për në Gjykatën e Lartë,

përveçse plotësimin nga ata edhe të disa kriterëve objektive siç mund të jetë kalimi me sukses i procesit të rivlerësimit kalimtar apo ardhja e tyre nga juridiksioni i gjykatave të apelit; b) aplikimin e transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve sipas nenit 46 të ligjit për Statusin, duke adaptuar rregullimet përkatëse në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, për të respektuar të gjitha parametrat kushtetues si dhe për të shmangur çdo aspekt që mund të duket si ngritje në detyrë e gjyqtarit përkatës, apo që të krijojë bindjen që i është dhënë statusi i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë; c) aplikimin e caktimit të gjyqtarëve në një çështje të caktuar, në ushtrim të përgjegjësisë së përcaktuar në pikën 1 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke adaptuar rregullimet përkatëse në vendimin nr. 30, datë 14.02.2019 “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Për të gjitha sa më sipër këto janë mundësitë më të mira ligjore, të cilat mund të përdoren sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në mënyrë sa më efikase, për të bërë të mundur daljen nga ngërçi në të cilën ndodhet Gjykata e Lartë. Ndërkohë që është detyrë funksionale e Këshillit, për të zgjidhur problemin e krijuar, për emërimin sa më të shpejtë të anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Zoti Qoku, shumë faleminderit për prezantimin dhe relacionin ezaures lidhur me problematikat aktuale që kemi në Gjykatën e Lartë dhe pse jo për propozimin e disa opsioneve që Këshilli duhet të marrë në konsideratë në këtë lloj mbledhjeje për të zgjidhur këtë lloj problematike.

Unë do ftoja kolegët nëse kanë ndonjë sugjerim apo koment lidhur me prezantimin e situatës dhe dhënien e opsioneve për zgjidhje të kësaj situate, të propozuar nga kolegu Qoku.

Medi Bici: Po, zonja Kryetare! Faleminderit!

Unë nuk kam ndonjë gjë me relacionin e paraqitur nga Nënkryetari, zoti Qoku, por mendoj që duhet të japë nja dy sqarime për të dalluar dy koncepte. Jam i mendimit se është momenti për të sqaruar se në rastin konkret Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk është në kushtet e zbatimit të nenit 136/1 të Kushtetutës, sipas të cilit Këshilli propozon anëtarët e

Gjykatës së Lartë, siç është bërë tashmë publike, Këshilli i ka shpallur vendet vakante për anëtarët e Gjykatës së Lartë (jo-gjyqtarë) dhe së shpejti pritet të përfundojë afati i paraqitjes së kandidaturave për të vazhduar me etapat e tjera të përzgjedhjes së tyre.

Për sa i përket çështjes që po shqyrtojmë sot, Këshilli mendoj që duhet të referoj direkt në nenin 147/1 të Kushtetutës, i cili shprehimisht thotë: “Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Duke qenë përgjegjës për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, Këshilli është i detyruar që të zgjidhë problemin e çështjeve më emergjente edhe në Gjykatën e Lartë, siç është rasti i nenit 494 të KPP.

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Bici!

Ndonjë koleg tjetër lidhur me...?

A jemi dakord që të kalojmë në propozimet në votim?

Po, zoti Toska përpara.

Ilir Toska: Faleminderit!

Të nderuar kolegë! Sot jemi përpara një situatë të krijuar në Gjykatën e Lartë, pra në organin më të lartë të pushtetit gjyqësor, situatë të cilën mendoj se nga sa duket, as hartuesit e reformës në drejtësi nuk kanë qenë në gjendje ta parashikonin dhe të sugjeronin për ligjvënësit propozimet konkrete për zgjidhjen e saj, zgjidhje këto që të shkonin konform kuadrit kushtetues dhe ligjor.

Fillimisht dua të deklaroj që opsioni që mua më duket më i përshtatshëm, racional dhe proporcional në raport me gjendjen e krijuar në Gjykatën e Lartë është opsioni i caktimit të gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të veçanta në Gjykatën e Lartë, ekskluzivisht për ato çështje që kanë të bëjnë me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, pikërisht me ekstradimet dhe transferimin e personave të dënuar, për të cilat Kodi i Procedurës Penale parashikon që vendimi i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm është vendimi i Gjykatës së Lartë. Thënë këtë, ka parasysh se Republika e Shqipërisë nuk mund t'i shmanget detyrimeve të konventave ndërkombëtare apo marrëveshjeve bilaterale me shtetet respektive, për të cilat nuk ka rëndësi reforma që ndërmerret me një shtet të caktuar, i cili pavarësisht çdo gjëje, është angazhuar ndërkombëtarisht për përmbushjen e detyrimeve të caktuara.

Ky opsion më duket më i përshtatshëm duke ndarë të njëjtin qëndrim me relatorin e çështjes sa i përket argumenteve juridike të parashtruar për këtë opsion, zgjidhje e cila gjithsesi është shumë e kufizuar, ndërkohë që zgjidhja e vërtetë dhe reale do të jetë plotësimi i vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, përmes procedurave strikte të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji, të cilat tashmë kanë filluar dhe shpresoj të përmbyllen sa më parë.

Nga ana tjetër, opsionet e skemës së delegimit, sipas nenit 45 të ligjit të Statusit dhe transferimit të përkohshëm, sipas nenit 46 të këtij ligji, mendoj se pavarësisht se në këto dispozita nuk përfshihet Gjykata e Lartë, në thelbin e tyre ato nuk shkojnë në të njëjtën linjë me dispozitën parimore të institutit juridik të transferimit, pjesë e të cilit janë edhe skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm, pikërisht me nenin 42 të ligjit të Statusit. Kjo dispozitë, në mënyrë të qartë përcakton se transferimi është a) lëvizja në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga një pozicion në një gjykatë ose prokurori, në një pozicion në një gjykatë ose prokurori tjetër të të njëjtit nivel; b) caktimi nga një pozicion i komanduar në një pozicion në gjykatë ose në prokurori, i cili është në të njëjtin nivel me pozicionin e mëparshëm; c) caktimi nga një pozicion i komanduar në një pozicion në gjykatë ose në prokurori të shkallës së parë, nëse magjistrati nuk ka pasur pozicione të mëparshme. Pra duket qartë se sipas këtyre opsioneve, sa i përket Gjykatës së Lartë, lëvizja e përkohshme e gjyqtarëve nuk është në të njëjtin nivel, por përkundrazi, është lëvizje vertikale, që do të thotë ngritje në detyrë.

Nisur nga kjo, ndërsa në thelb sipas këtyre dy opsioneve jemi para ngritjes në detyrë, kjo e fundit është institut juridik më vete dhe rregullohet posaçërisht nga ligji i Statusit, nenet 47 dhe vijues, ku referuar të cilëve, përveç kriterit formal të përvojës në profesion si dhe kalimit të testit të figurës dhe pasurisë, kërkohet edhe plotësimi i kriterit të meritokracisë, pra gjyqtari të promovohet, të jetë më i miri ndër kandidatët sipas dy vlerësimeve etike dhe profesionale. Ndërkohë, këto kritere të ngritjes në detyrë, nuk janë kritere për skemën e delegimit apo transferimin e përkohshëm, të cilat në thelb kërkojnë vetëm pëlqimin e gjyqtarit dhe plotësimin nga ai të kriterit për pozicionin, përvojën dhe specializimin.

Në fakt, sipas mendimit tim, qëllimi i ligjvënësit, sa i përket skemës së delegimit dhe transferimit të përkohshëm nuk ka qenë për të zgjidhur situata të caktuara në Gjykatën e Lartë. Këtë qëndrim ka mbajtur Këshilli edhe në rastin e miratimit të rregullave më të detajuara për skemën e delegimit, me vendimin nr. 22, datë 07.02.2014 (*lapsus viti 2014, bëhet fjalë për 07.02.2019*) “Për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, si dhe për transferimin e përkohshëm, me vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 “Për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”.

Përveç kësaj, nga pikëpamja kushtetuese, mendoj se gjyqtari i Gjykatës së Lartë është i emëruar definitivisht dhe me mandat të kufizuar 9-vjeçar, çka nuk lë shteg për interpretim që mund të ketë edhe gjyqtarë që ushtrojnë funksionin për periudha të caktuara, duke qenë të paemëruar dhe pa mandat ligjor, pra të një gjyqtari të përkohshëm. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit zoti Toska, lidhur me qëndrimin tuaj për opsionet e propozuara nga relatori.

Po! Zoti Muharremaj!

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Në vijim të asaj çka referoi edhe kolegu Toska dhe të relacionit të paraqitur nga Zëvendëskryetari i Këshillit dhe zoti Bici, ndaj të njëjtin mendim për sa i përket përshtatshmërisë së propozimit të tretë, për sa i përket caktimit të gjyqtarëve për të gjykuar çështje të veçanta, nisur nga karakteri emergjent i situatës në të cilën ndodhemi. Përveç detyrimit kushtetues të përmendur nga zoti Bici që iu referua nenit 147/1 të Kushtetutës, do përsërisja edhe një herë detyrimin që ka Republika e Shqipërisë për të respektuar marrëveshjen ndërkombëtare të detyrueshme për të referuar nenit 5 të Kushtetutës, rendit hierarkik që Kushtetuta u ka caktuar marrëveshjeve ndërkombëtare, referuar nenit 116 të saj, si dhe parashikimit të bërë nga paragrafi i dytë i nenit 122 të Kushtetutës.

Përveç kësaj, gjykoj që vendimmarrja e Këshillit në rastin konkret do të ishte edhe në proporcion me nevojën emergjente që ka Gjykata e Lartë aktualisht dhe i referohem të ashtuquajturit parim të proporcionalitetit që përfshin në vetvete plotësimin e tre kriterëve:

atë të përshtatshmërisë - që do të thotë masa e marrë të jetë e përshtatshme për të arritur objektivin; atë të nevojshmërisë - ndodhemi në kushtet kur një masë më pak kufizuese nuk do të mundësonte arritjen e objektivit të synuar; dhe të proporcionalitetit – në kuptimin e ngushtë, që masa nuk duhet të jetë në shproporcion me objektivin dhe të ekzistojë një lidhje e arsyeshme proporcionale midis mjetit të përdorur dhe objektivit të synuar.

Do t'ju lutesha të përmend edhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sa i përket të ashtuquajturës “Gjykatë të caktuar me ligj” dhe në lidhje me vet përbërjen e saj në çështjen “*Buscarini kundër San Marino*”, gjykata ka analizuar në detaje kuptimin e “Gjykatës të caktuar me ligj”, theksi vendoset tek mos caktimi i një gjyqtari në mënyrë arbitrare dhe këtu Këshilli vendimmarrjen e merr në dispozitat e referuara më sipër sa i përket Kushtetutës, kriteri që të respektohet paanësia e gjyqtarit, garancitë procedurale, kohëzgjatja në detyrë dhe sidomos ata që kanë të bëjnë me integritetin e gjyqtarit.

Siç është parashikuar në pikën 4 të projektvendimit, gjyqtarët që do të caktohen për këto çështje të veçanta, të përzgjidhen ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të apelit të cilët kanë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve”, që do të thotë që nuk ka asnjë pikëpyetje në lidhje me integritetin e gjyqtarëve që po caktohen.

Kështu që unë po shpreh qëndrimin tim personal, që është pro alternativës së tretë, që ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për të gjykuar çështjet e karakterit emergjent, në rastin konkret në Gjykatën e Lartë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Muharremaj lidhur me qëndrimin tuaj shumë ezaurues, për sa i përket opsionit për të cilin ju shprehni votën tuaj.

Ndonjë diskutim tjetër lidhur me opsionet e propozuara?

Atëherë, duke qenë se relatori i kësaj çështjeje, e cila është një çështje shumë sensitive dhe shumë e rëndësishme, u mundua që në mënyrë shumë ezauruese të na i shpjegonte të gjithë situatën faktike dhe gjithashtu duke na dhënë të gjithë argumentet sepse ne nuk jemi në kushtet e emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, të paktën

ashtu si është keqinterpretuar dhe në shumë media, por jemi në kushtet e marrjes së një mase, e cila ka të bëjë me funksionalitetin e kësaj gjykate, unë doja t'ju rikujtoja edhe një herë që Këshilli, përpara se të marri në shqyrtim këtë çështje, detyra ishte që të bënte këtë gjykatë (Gjykatën e Lartë) sa më funksionale dhe ashtu siç e përmendi edhe relatori, kemi marrë të gjithë masat dhe është duke punuar intensivisht që në shtator këtë gjykatë ne ta kemi funksionale me anëtarët e zgjedhur, anëtarë të cilët do të jenë të përzgjedhur nga ato kandidatë që plotësojnë kriteret e profesionalizmit, por nga ana tjetër edhe kriterin e integritetit, pra verifikimit të pasurisë dhe të figurës. Por, nisur nga urgjenca dhe sensitiviteti i këtyre çështjeve që ka Gjykata e Lartë, është shumë e nevojshme që Këshilli, në respektim të kuadrit ligjor që Gjykata e Lartë është nën drejtimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, është shumë e nevojshme që Këshilli të reagojë edhe më një masë të karakterit të përkohshëm lidhur me këto çështje, të cilat në gjykimin tim por edhe në atë të propozuar nga relatori, janë çështje me të vërtetë emergjente dhe nuk mund të tolerojmë që këto çështje të jenë të pa adresuara në situatën që ndodhemi. Aq më shumë, propozimi i dhënë është një propozim që edhe unë bie dakord me parafolësin, një propozim proporcional sepse edhe ato gjyqtarë që sugjerohen që të aplikohen sipas këtyre opsioneve, pa diskutim që do jenë pjesë të trupës gjyqësore që jo vetëm plotësojnë kriteret ligjore, por që i kanë kaluar të gjithë instancat e vlerësimit kalimtar, për të bërë ato të vlefshëm dhe të denjë për të gjykuar këto çështje në Gjykatën e Lartë.

Atëherë, nëse ne nuk kemi më diskutime për sa i përket çështjes, unë do preferoja t'ju sqaroja sesi kemi proceduar lidhur me shqyrtimin e këtyre opsioneve, pavarësisht se relatori ka propozuar tre opsione. Pa diskutim që në punën e grupit që kemi pasur, jemi munduar që t'i adresojmë këto opsione edhe me propozime konkrete te aktet nënligjore. Pra nëse faza e parë e këtij votimi do jetë se cili nga opsionet do të zgjedhim, faza e dytë e këtij votimi do të jetë rregullorja e cila adreson zgjidhjen sipas secilit opsion. Kështu, në varësi të vendimmarrjes tonë, do kalojmë edhe ndryshimet përkatëse që relatori bashkë me Komisionin përkatës ka gjykuar që duhet të adresojë këto opsione. Po, zonja Ukperaj dëshiron fjalën!

Brikena Ukperaj: Ajo që unë doja të theksoja sepse ndoshta ne bëmë disa, këtu u bënë shumë diskutime është çështja së pari a duhet të ndërhyjë Këshilli i Lartë Gjyqësor në këtë moment, pse dhe pse për këtë çështje.

Aktualisht, të gjitha çështjet në Gjykatën e Lartë presin të shqyrtohen dhe sigurisht jemi të gjithë koshient që drejtësia po vonon për shkak të mungesës së funksionalitetit të Gjykatës së Lartë. Ideja është që çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, pra këto çështje të ekstradimit, paraqesin urgjencë për shkak të masave të sigurimit të caktuara për efekt të këtyre procedurave. Në ndryshim nga gjithë kompetenca e Gjykatës së Lartë për çështje të ekstradimit, Kodi i Procedurës parashikon që nëse Gjykata e Lartë, vendimi i së cilës është i formës së prerë në dallim nga rastet e tjera, nuk shprehet për kërkesën për ekstradim brenda 3 muajve, masa shtrënguese, përfshirë këtu edhe “arrestin në burg”, revokohet. Qëllimi i masës së sigurimit në kuadër të një procedure ekstradimi është që të garantojë zbatimin efektiv të procedurës, që përfundon me dorëzimin e shtetasit tek shteti kërkuar.

Revokimi i masës së sigurimit, për shkak se nuk ka gjyqtarë në Gjykatën e Lartë që të shqyrtojnë çështjen, sigurisht që është përgjegjësi e Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili ka detyrën për të garantuar funksionalitetin e Gjykatës së Lartë. Aktualisht Këshilli i Lartë Gjyqësor ndodhet përpara dy detyrimeve kushtetuese. Së pari, para detyrimit kushtetues që të bëjë funksionale Gjykatën e Lartë me gjyqtarë të emëruar me Dekret të Presidentit dhe së dyti, pikërisht për shkak të kësaj situatë faktike, kur tre ose më shumë kërkesa për ekstradim janë pothuajse në limitet e afatit kohor për t'u shqyrtuar, të sigurojë mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor.

Për këtë arsye, mbështes propozimin për të ndërhyrë Këshilli i Lartë Gjyqësor në situatën e krijuar në Gjykatën e Lartë vetëm për sa i përket këtyre çështjeve të kësaj natyre, prandaj edhe mendoj që skema e delegimit dhe transferimi, për shkak të mënyrës se si janë të konceptuara në ligj, nuk mund të sjellin zgjidhje. Duke konsideruar si një masë urgjente, ekstreme të fundit, e vetmja mënyrë e ndërhyrjes së Këshillit do të ishte nëpërmjet rregullores së caktimit të gjyqtarëve për një çështje të caktuar, por që e cila në vetvete kërkon edhe ajo një amendim, një shtesë, për shkak sepse nuk është parashikuar

në rregullore mënyra se si do të operohet në rastet kur emergjenca shfaqet në Gjykatën e Lartë.

Prandaj do të doja të shfaqja edhe unë qëndrimin tim lidhur me variantin e tretë të propozuar, por duke mëshuar faktit që bëhet pikërisht vetëm për çështjet që kanë të bëjnë me ekstradimet, kur vihet në rrezik e gjithë procedura e ekstradimit për shkak të revokimit të masës dhe kalimit të afateve. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit zonja Ukperaj, lidhur me shprehjen e qëndrimit tuaj për sa i përket një nga opsionet e propozuara nga relatori.

Atëherë, a mendoni që të kalojmë tek faza e parë, pra sikurse jua bëra me dije, po mundohem t’jua ripërsëris, relatori ka propozuar tre opsione për zgjidhjen e kësaj situate të paprecedentë në Gjykatën e Lartë.

Medi Bici: Kryetare, ke dy kërkesa që të kalosh në variantin e tretë.

Naureda Llagami: Ta kalojmë tek varianti i tretë?

Medi Bici: Edhe të Ilirit edhe të zotit Erjon.

Maksim Qoku: Meqë jam personi që u mor me të gjithë opsionet, bile unë jam personi që kam qen kundër këtij vendimi të dërgimit të gjyqtarit në çështje, por jemi në situatë emergjente, çka do të thotë, të dyja opsionet e tjera i rrëzoj për situatën emergjente, aq më tepër që kam frikë që aplikimi i atyre dy zgjidhjeve të tjera, mund edhe të konfundojë përgjithësisht opinionin sepse duket sikur ne e cenam parimin “check and balance”, shmangëm Presidentin dhe çuam dikë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye dhe të gjitha argumentimet që kam dhënë tek rasti i fundit, që jam zgjeruar për të legjitimuar atë ç’kam dashur të them, edhe unë mbetem tek të mbetemi tek opsioni i fundit, të zgjidhim emergjencën dhe të marrim vendim sot në lidhje me këtë që kam referuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, shumë faleminderit zoti Qoku!

Sikurse ju informova edhe më parë, për çdo opsion kemi marrë masa për reflektimin në ndryshim të rregulloreve përkatëse për të qenë në parantezë të vendimmarrjes tonë. Duke qenë se rezulton që pjesa më e madhe e anëtarëve ka shprehur pëlqimin dhe kërkesën lidhur me votimin e opsionit të tretë, pra opsioni i tretë ka të bëjë lidhur me aplikimin e caktimit të gjyqtarëve në një çështje të caktuar në ushtrimin e

përgjegjësisë së përcaktuar në pikën 1 të nenit 147 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë duke adaptuar rregullimet përkatëse në vendimin nr. 30, datë 14.02.2019 “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozoj që të kalojmë në votim së pari opsionin dhe më pas të na relatohet reflektimi i këtij opsioni në rregullore. Dakord?

Kalojmë në votim opsionin e tretë lidhur me zgjidhjen e çështjes në Gjykatë të Lartë.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi që lidhur me zgjidhjen e problematikës emergjente të krijuar në Gjykatën e Lartë, do të vijojë me ndryshimin e rregullores “Për rregullat e procedurës së caktimit të gjyqtarit për gjykimin në një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Ashtu sikurse ju thashë edhe në fillim, jemi munduar që të marrim masa që për të tre opsionet të kishim projekt draft rregulloret. Në situatën që kjo rregullore i përket kompetencës në fushën e veprimtarisë së Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, doja që të propozonte ndryshimet përkatëse për këtë lloj rregullore, për të adresuar çështjen në Gjykatën e Lartë. Zoti Ilir Toska!

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, marrë shkas nga variantet e propozuara nga relatori i çështjes lidhur me problematikat e krijuara në Gjykatën e Lartë, duke pasur në konsideratë tashmë që Këshilli ra dakord, u dakordësua që do duhet të operojë me një shtesë në rregulloren në vendimin nr. 30, datë 14.02 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar edhe një projektvendim për këtë qëllim. Ky projektvendim konsiston në shtimin e një dispozite të veçantë për Gjykatën e Lartë, numërtuar X/1.

Në pikën e parë të kësaj dispozite shtesë parashikohet zbatueshmëria e vendimit nr. 30, datë 14.02.2019 edhe për Gjykatën e Lartë, sikundër edhe periudha tranzitore e zbatimit të këtij vendimi, duke u parashikuar se ky vendim do të zbatohet edhe për Gjykatën e Lartë derisa pranë saj të jetë funksionale një trupë gjykuese.

Në pikën 2 të dispozitës shtesë parashikohet ajo çka përbën “Nevojë të Gjykatës së Lartë” në kuptim të këtij vendimi, duke u përcaktuar se e tillë konsiderohet vetëm ajo që lidhet me gjykimin e çështjeve gjyqësore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, ekskluzivisht me ekstradimin dhe transferimin e personave të dënuar, për të cilat shkronja /c/, pika 3, e nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale parashikon që vendim i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm është vendimi i Gjykatës së Lartë.

Në pikën 3 të dispozitës shtesë parashikohet mënyra se si vihet në lëvizje Këshilli i Lartë Gjyqësor në rastin e nevojës së Gjykatës së Lartë, duke u parashikuar se Këshilli vihet në lëvizje me kërkesë të kancelarit të Gjykatës së Lartë.

Në pikën 4 të dispozitës shtesë parashikohen kriteret që duhet të përmbushin gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e çështjeve të veçanta në Gjykatën e Lartë, si dhe mënyra e përzgjedhjes së tyre, duke u parashikuar se ata përzgjidhen me short ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të apelit, të cilët kanë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Së fundmi, në projektvendim parashikohet që vendimi hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë sugjerim, koment lidhur me projekt-aktin e propozuar?

Ju lutem, kolegë!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit të propozuar?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin për disa shtesa në vendimin nr. 30, datë 14.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin...”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 23.07.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 19.07.2019”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:10 dhe mbaroi në orën 15:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoreshë e Kabinetit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Antuen Skënderi, Këshilltare e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse pranë Sektorit të Organizimit të Mbledhjeve Plenare.*
6. *Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.*
7. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
8. *Aurora Ndreu, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike dhe Përafrimit të Legjislacionit.*
9. *Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
10. *Marjana Papa, OSCE.*
11. *Migena Kondo, KSHH.*
12. *Gregor Borgowski, EURALIUS.*
13. *Klodian Rado, EURALIUS.*
14. *Valbona Bala (Pajo), USAID.*
15. *Erion Fejzulla, USAID.*
16. *Julinda Karaboja, USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 19.07.2019”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, e cila edhe kjo çështje nuk është më pak e rëndësishme se sa ishte çështja e parë.

Më së fundi, jemi në momentin e caktimit në detyrë të magjistratëve të rinj, që ne, siç jemi në dijëni, patëm mundësi që t’i emëronim javës së shkuar.

Lidhur me relatimin e projekt-aktit “Për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor më datë 19.07.2019”, po ia kaloj fjalën kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim “Për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 19.07.2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 35 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendimet nr.127, nr.128, nr.129, nr.130, nr.131, nr.132, nr.133, nr.134, nr.135 dhe nr.136, të datës 19.07.2019, emëroi si gjyqtarë 10 kandidatët e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.

Nisur nga kjo, në zbatim të pikës 1, të nenit 39 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 19.07.2019”, i cili i hap rrugë caktimit në pozicion të të emëruarve.

Lidhur me këtë projektvendim vlen të theksohet se shpallja e vendeve të lira për të emëruarit po bëhet pa u realizuar më parë nga Këshilli procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, procedura për të cilat Këshilli do të duhet më parë të plotësojë kuadrin ligjor me akte nënligjore, të cilat janë në proces përgatitjeje dhe miratimi, përveç se do të duhet të realizojë dhe proceset e vlerësimit etik dhe profesional për kandidatët e mundshëm, çka e cila do të kërkonte ende kohë. Vlen të theksohet se një proces i tillë, nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, është përfunduar tërësisht për të gjithë gjyqtarët vetëm për vitet 2007-2009, pra për një periudhë të përpara 10 vjetëve.

Ndërkohë, gjyqtarët e emëruar më datë 19.07.2019, janë diplomuar në vitin 2018, pra kanë një vit në pritje të emërimit dhe caktimit në pozicion. Përveç kësaj, në kushtet kur ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për shkak të ligjit, ka patur të pamundur emërimin dhe caktimin e tyre në pozicion, ata kanë iniciuar një proces gjyqësor, ku me vendimin të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë është detyruar financiarisht për t’iu paguar dëmshpërblim, në masën e pagës, 10 të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.

Ndërkohë, gjyqtarët e emëruar më datë 19.07.2019, janë diplomuar në vitin 2018, pra kanë një vit në pritje të emërimit dhe caktimit në pozicion. Përveç kësaj, në kushtet kur ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për shkak të ligjit, ka patur të pamundur emërimin dhe caktimin e tyre në pozicion, ata kanë iniciuar një proces gjyqësor, ku me vendimin të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tirane, ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë është detyruar financiarisht për t'iu paguar dëmshpërblim, në masën e pagës, 10 të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018. Ky vendim është dhënë me ekzekutim të përkohshëm dhe aktualisht Këshilli i Lartë Gjyqësor në është duke bërë pagesat përkatëse në favor të tyre.

Në këtë situatë, kur nga njëra anë Këshilli i Lartë Gjyqësor po iu paguan praktikisht pagën të diplomuarve të emëruar tashmë si gjyqtarë, këta të fundit vijojnë të mos ushtrojnë funksionin e gjyqtarit për sa kohë nuk janë caktuar në pozicion. Dhe përveç kësaj, situata e burimeve njerëzore në gjykata sa vjen dhe bëhet akoma më e vështirë. Në një situatë të tillë do të ishte luks për Këshillin e Lartë Gjyqësor të vijonte pagesat për të emëruarit tashmë si gjyqtarë, në pritje të realizimit më parë të lëvizjeve paralele dhe ngritjes në detyrë, ndërsa sistemi gjyqësor është në vështirësi të theksuara për gjyqtarë, ku funksionaliteti në shumë gjykata ose ka humbur ose është në kufijtë e humbjes.

Duhet përmendur se mbi propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Kuvendi i Shqipërisë, më datë 18.07.2019, në kuadër të disa ndryshimeve dhe shtesave në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, miratoi një projektligj, ku përmes një dispozite kalimtare, iu la mundësi Këshillave (KLGJ-së dhe KLP-së) që të veprojnë me caktimin në pozicion të të emëruarve, pa bërë më parë lëvizjet paralele dhe ngritjet në detyrë. Gjithsesi ky projektligj i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë ende nuk ka hyrë në fuqi, prandaj parashtrimi i këtij fakti nuk bëhet në funksion të referimit në të të projektvendimit në shqyrtim, por për të evidentuar atë çka organi ligjvënës ka vlerësuar tashmë.

Në lidhje me projektvendimin e propozuar, ai është i strukturuar në 7 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet urdhërimi për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 19.07.2019.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohen vendet e lira, që janë 11, duke u përzgjedhur ato pikërisht në konsideratë të numrit të gjyqtarëve të emëruar më datë 19.07.2019, të pozicioneve të lira në sistemin gjyqësor, organikat aktuale dhe ato në fakt të gjykatave, si dhe numrin minimal të gjyqtarëve të përcaktuar nga ligji për gjykatat e shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm dhe administrativ. Vendet e lira për të cilat gjyqtarët e emëruar mund të aplikojnë, në këtë pikë të projektvendimit, janë prezantuar si më poshtë: një pozicion në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër; një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër; një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat; një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë; një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës; një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin; një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë; një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe një pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Në pikën 3 të projektvendimit parashikohet se gjyqtarët e emëruar kanë të drejtë të përcaktojnë, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata nga ato sipas pikës 2, në të cilat ata kërkojnë të caktohen.

Më tej, në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtarët e emëruar duhet të deklarojnë edhe për ekzistencën lidhjeve të tyre familjare me magjistratë (gjyqtarë ose prokurorë) që ushtrojnë funksionet në gjykatat ose prokuroritë pranë gjykatave sipas pikës 2 të këtij vendimi.

Ndërkohë, në pikën 5 të projektvendimit është përcaktuar afati i aplikimit nga të emëruarit, duke u përcaktuar ky afat deri më datë 26.07.2019, ndërsa mungesa e aplikimit është parashikuar se nuk passjell ndalimin e procedurës së caktimit në pozicion të të emëruarve.

Në pikën 6 të projektvendimit është parashikuar dokumentacioni që gjyqtari i emëruar duhet të dorëzojë në momentin e aplikimit, duke u përcaktuar se ai duhet të paraqesë këto dokumente: një deklaratë me shkrim ku përcakton, sipas renditjes preferenciale tri gjykata nga ato sipas pikës 2, në të cilat kërkon të caktohet, si dhe një

deklaratë me shkrim për ekzistencën lidhjeve familjare me magjistratë (gjyqtarë ose prokurorë) që ushtrojnë funksionet në gjykatat sipas pikës 2 të këtij vendimi.

Në pikën 7 të projektvendimit është përcaktuar vendi i dorëzimit të dokumentacionit nga gjyqtarët e emëruar, pikërisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Së fundmi, në projektvendim është parashikuar dhe koha e hyrjes në fuqi të tij, duke u përcaktuar se ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit, zoti Toska për relatimin e projekt-aktit!

Nëse nuk keni ndonjë diskutim konkret lidhur me pikën e projekt-aktit, kalojmë në vendimmarrjen e tij?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit “Për shpalljen e vendeve të lira për gjyqtarët e emëruar më datë 19.07.2019” sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Kaq ishte rendi i ditës për shqyrtim për ditën e sotme.

Nëse nuk keni ndonjë çështje tjetër paraprake, unë e deklaroj mbledhjen të mbyllur. Faleminderit, për prezencën.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor